

	TRAINKOS SH.A. TRAINKOS D.D. TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br.	<u>1/63</u>
Dt.	<u>17.03.2015</u>
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje	



Rregullore

Mbi punën e arkës dhe përdorimin e parave të gatshme

Fushë Kosovë

Mars 2015

Në mbështetje të Nenit 20 të Ligjit 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në bazë të nenit 26.23 të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP, Bordi i Drejtorëve i HK TRAINKOS Sh.A në Mbledhjen Nr. 52 të mbajtur më 13 dhe mw 17.03.2015 miratoi këtë:

RREGULLORE

Mbi punën e arkës dhe përdorimin e parave të gatshme

Neni 1

Me qëllim të përkrahjes së aktiviteteve ditore dhe aktiviteteve të operimeve Hekurudhat e Kosovës-Trainkos-Sh.A kanë në përdorim arkën e cila mbështet aspektin financiar të transaksioneve komerciale.

Neni 2

Hekurudhat e Kosovës –Trainkos-Sh.A arkën e kanë të vendosur në selinë qendrore në Fushë Kosovë e cila operohet nga arkëtari i kompanisë.

Neni 3

Aktivitetet ditore të arkës përfshijnë punën e cila ka të bëjë me pranimin e blloqeve të biletave të udhëtareve për të gjitha kategoritë e biletave ngarkimin e konduktorëve me blloka të biletave të udhëtarëve , pranimin e parave të gatshme nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe barazimin e blloqeve të dorëzuara me të hollat e pranuar.

Neni 4

Arka e Trainkos Sh.a bënë pranimin e parave nga arkëtimet e bëra në rastet kur paratë nuk mund të dorëzohen në llogarinë e Hekurudhave të Kosovës –Trainkos-Sh.A, barazimi i parave të dorëzuara në llogarinë bankare të Trainkos sh.a , si dhe parave të gatshme të dorëzuara në arkë me raportin përkatës të terminalit.

Neni 5

Arka e Trainkos Sh.A bënë të gjitha pagesat e paradhënies të punëtorëve të Trainkos Sh.A për shuma deri në 100 € dhe paradhënies për udhëtime zyrtare shuma e të cilave përcaktohet me rregulloren mbi udhëtimet zyrtare dhe barazimin e këtyre paradhënies brenda shtatë ditëve ose më së voni tri ditë pas kthimit nga udhëtimi zyrtar.

Neni 6

Fushëveprimi i arkës së Trainkos Sh.A përfshin edhe pagesat e faturave për shpenzime të ndryshme të kompanisë, vlera e të cilave është deri në 100 € me autorizim të Menaxherit të Financave dhe me

autorizim të veçantë të Drejtorit Financiar për shumat mbi 100 €, kur nuk kanë mundësi të paguhen përmes bankës.

Neni 7

Arka e Trainkos Sh.A ka të caktuar limitin e epërm në vlerë prej 3,000.00 €, ndërsa limitin e poshtëm në vlerë prej 500.00 €.

Neni 8

Arka është e detyruar që gjatë aktiviteteve ditore të zbatoi procedurat përkatëse për shkak të punës së ndjeshme të saj.

Neni 9

Arkëtari i Trainkos Sh.A është i detyruar që të ushtroi kërkesën me shkrim në prokurim për furnizim me blloqe të biletave të të gjitha kategorive , sipas gjendjes së biletave, sipas udhëzimit nga sektori i komerciales mbi minimumin e stoqeve të biletave.

Neni 10

Arkëtari është e detyruar që të gjithë konduktorët ti ngarkoi me blloqe të biletave të udhëtarëve të të gjitha kategorive , sipas numrave serik dhe të mbajë evidencë veç e veç për çdo konukter mbi gjendjen e blloqeve të ngarkuara, si dhe bënë pranimin e parave të dorëzuara dhe bënë barazimin javor.

Neni 11

Arkëtari në bazë të evidencës për çdo konduktorë përcjell gjendjen e blloqeve të biletave të udhëtarëve me të cilat janë ngarkuar konduktorët , bënë pranimin e parave të dorëzuara dhe barazimin javorë, mujorë (më së largu deri më datë 03 të muajit vijues).

Neni 12

Poashtu arkëtari është i obliguar që në bazë të evidencës së punës së konduktorit të përcjell parregullsitë e tij dhe për këtë të njofton me shkrim shefën i shërbimit të transportit të udhëtarëve për të marrë masat e nevojshme ndaj konduktorit .

Neni 13

Arka e Trainkos Sh.A bënë arkëtimin e pagesave duke shënuar në bllok numrin e klientit, emrin dhe mbiemrin, numrin e faturës që paguan dhe shumën në EURO.

Neni 14

Pagesën e paradhënies arka e bënë përmes kërkesës së autorizuar nga drejtori i departamentit përkatës dhe të aprovuar nga Menaxheri i financave. Pas pagesës së shpenzimeve, marrësi i paradhënies prezanton

tek arkëtari faturat mbi shpenzimet dhe diferencën pozitive/negative dhe bënë barazimin . Kur shpenzimi tejkalon shumë e paradhënies, bëhet autorizimi/aprovimi për shumë shtesë. Paradhëniet e marra duhet të mbyllen më së voni 7 (shtatë) ditë pas marrjes së paradhënies.

Neni 15

Pagesa e faturave të ndryshme bëhet pas prezantimit të faturës dhe formularit mbi vlerësimin e nevojave me autorizimet /aprovimet përkatëse.

Neni 16

Arkëtari i Trainkos Sh.A përkujdeset që limitet e përcaktuara të arkës të respektohen duke dorëzuar paratë e gatshme mbi limitin e lartë në ditën vijuese pas ditës kur kjo tepricë e limitit konstatohet dhe duhet të rimbushë arkën duke tërhequr para të gatshme nga llogaria bankare në rast se saldo e parave të gatshme e kalon limitin e poshtëm, gjithmonë duke bërë planifikimin e parave të gatshme sipas nevojave rrjedhëse të Trainkos Sh.A.

Neni 17

Arkëtari i Trainkos Sh.A është i obliguar që të mbajë ditarin e arkës dhe raportin javor ta dorëzoj te menaxheri i financave çdo të hënë, për javën që ka përfunduar dhe duhet të bëjë barazimin e raportit të arkës me gjendjen në arkë sipas sektorit të financave.

Neni 18

Menaxheri i financave, bashkë me kontabilistin në fund të çdo muaji bëjnë numërimin fizik të parave të gatshme dhe barazimin e gjendjes aktuale me gjendjen sipas librave përkatëse të arkës.

Neni 19

Trainkos Sh.A kontrollon punën e arkës përmes komisionit të caktuar nga menaxhmenti i cili është i detyruar që të bëjë në çdo kohë verifikimin/kontrollin e gjendjes faktike të parave në arkë me gjendjen e librave përkatëse të arkës.

Neni 20

Kjo rregullore hyn në fuqi nga data e nënshkrimit të së njëjtës dhe pushon së vepruari Rregullorja e mëparshme.



Heset Cakolli

Kryesues i Bordit të HK-Trainkos Sh.A